

KONTRATË BINJAKËZIMI

**Përkrahje për Statistikat****Kosovë****RAPORT MBI MISIONIN****Përkrahje në përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve:  
Krijimi i procedurave për futjen e të dhënave dhe paraqitjes për përdoruesit****Komponenti nr 3.5.7**

Misioni i udhëhequr nga  
Søren Netterstrøm, Statistikat e Danimarkës  
19-22 Janar 2015

|  |  |  |
|--|--|--|
|  |  |  |
|  |  |  |

*IPA 2012**Søren Netterstrøm*

*Statistikat e Danimarkës*  
*Farverstræde 6*  
*DK-4850 Stubbekøbing*  
*Denmark*  
*Tel: +45 5444 0475*  
*Email: [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)*

## Përmbajtja

|  |  |
|--|--|
| 1. Komentet e përgjithshme .....       | 4  |
| 2. Gjendja aktuale .....               | 4  |
| 3. Aplikacioni online .....            | 4  |
| 4. Njësitë që mungojnë prej ARBK ..... | 5  |
| 5. Transaksionet e papfunduara .....   | <b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b> |
| 6. Misioni i radhës .....              | <b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b> |
| Aneksi 1. Termet e Referencës .....    | 6  |
| Aneksi 2. Personat e takuar .....      | 9  |

## Shkurtesat

|       |   |
|-------|---|
| GSBPM | Modeli i përgjithshëm i procesit të prodhimit statistikor |
| ASK   | Agjencia e Statistikave të Kosovës                        |
| ARBK  | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare             |
| NACE  | Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev.2              |
| RSB   | Regjistri Statistikor i Bizneseve                         |
| SBS   | Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve                   |
| SIDA  | Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar                |
| SQL   | Structured Query Language                                 |
| STS   | Statistikat Afatshkurtra                                  |
| ATK   | Administrata Tatimore e Kosovës                           |
| TeR   | Termet e Referencës                                       |
| TVSH  | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar                                |

## 1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Ky është misioni i dhjetë, që i kushtohet Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB) në kuadër të komponentit 3 të projektit.

Tema kryesore e këtij misioni ka qenë rishikimi i punës së bërë lidhur me aplikacionin online për qasje dhe azhurnim të RSB-së. Një temë tjetër e rëndësishme ka qenë trajtimi i transaksioneve të papërfunduara dhe çështjeve të tjera, që është hasur gjatë zhvillimit të RSB-së.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

**Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.**

## 2. Gjendja aktuale

Nuk ka pasur ndonjë azhurnim të RSB-së nga burimet administrative që nga misioni i paraprak. Është arritur një progres i konsiderueshëm në zhvillimin e aplikacionit online, por ka mbetur ende punë para se të prodhohet versioni i parë.

## 3. Aplikacioni online

Z. Kastrati ka arritur një progres të konsiderueshëm në punën rreth aplikacionit online që nga misioni i kaluar. Është krijuar një kërkim shumë fleksibil, që i mundësohet përdoruesve të gjejnë njësitë, që iu interesojnë, ose në nivel të ndërmarrjeve, ose të njësive ligjore. Me këtë rast shfaqen të gjitha informatat vitale në njësinë e selektuar (nga lista e njësive, që i plotësojnë kriteret e kërkimit), përfshirë kodet e aktivitetit, listën e njësive lokale, të dhënat mbi qarkullimin dhe të dhënat mbi punësimin.

Është e lehtë të kalohet nga një lloj i njësisë në të tjerat, të lidhura me këtë njësi, nga ndërmarrja në njësi ligjore, nga ndërmarrja në njësinë lokale dhe nga njësia ligjore në ndërmarrje.

Është e mundur të azhurnohen njësitë statistikore. Njësitë administrative sipas definicionit nuk mund të azhurnohen.

Eksperti ka propozuar një numër të vogël ndryshimesh në aplikacion. Disa të dhëna mungonin në ekran. Për kodet e aktivitetit, në pamje të përgjithshme sugjerohet të shfaqen vetëm kodet aktive dhe pastaj të shfaqet historia e plotë në një dritare, varësisht nga kërkesa. Ngjashëm për qarkullimin dhe punësimin, sugjerohet të shfaqet vetëm shifra e kalkuluar (kodi 89) në dritaren kryesore.

Në listën e njësive, për të plotësuar kriterin e kërkimit, sugjerohet të shfaqet vetëm identifikimi i njësisë, emri dhe adresa, meqenëse qëllimi i kësaj liste është vetëm selektimi i njësisë, për të cilën do të shfaqen të gjitha detajet. Kjo po ashtu vlen për listën e njësive lokale, ku detajet shfaqen në një dritare të veçantë, sipas kërkesës.

Është vendosur që Z. Kastrati të vazhdojë të punojë në aplikacionin duke marrë në konsideratë këto sugjerime.

Gjatë misionit është përdorur aplikacioni prototip në ekzaminimin e transaksioneve të papërfunduara dhe është dëshmuar të jetë i dobishëm.

#### **4. Njësitë që mungojnë nga ARBK**

Gjatë punës me transaksionet e papërfunduara është parë që regjistri i ATK-së përmban një numër të njësive me numër të regjistrimit të bizneseve që nuk mund të gjendet në të dhënat nga ARBK-ja. Duke përdorur Web-sistemin e ATK-së dhe ARBK-së, është konfirmuar që njësitë janë regjistruar në ATK, por nuk gjenden në ARBK.

Z. Kastrati do të kontaktojë ARBK-në në lidhje me këtë çështje, pasi kjo tregon që ka pasur disa probleme në ARBK. Duket që mungojnë gjithsej 1000 njësi. Pasi ARBK është burim primar për njësitë ligjore, kjo çështje duhet të zgjidhet.

#### **5. Transaksionet e papërfunduara.**

Azhurnimi automatik i RSB nga ARBK, jo gjithmonë mund të përcaktojë se si duhet të azhurnohen njësitë statistikore.

Një shembull është rasti kur njësia kryesore ligjore, njësia në të cilën bazohet ndërmarrja, mbyllet dhe ka disa njësi të tjera ligjore të lidhura me ndërmarrjen, që janë ende aktive.

Në këtë rast krijohet një transaksion i papërfunduar. Kjo kërkon intervenim manual për të përcaktuar cila prej njësive ligjore të mbetura të selektohet si njësi e re kryesore.

Deri tani këto raste nuk janë trajtuar për shkak të mungesës të sistemit online. Gjatë këtij misioni janë zbuluar rastet e pazgjidhura dhe janë zgjidhur. Është krijuar dhe përdorur një procedurë speciale për trajtimin e këtij ndryshimi kompleks. Po ashtu, procedura e azhurnuar është zgjeruar për të trajtuar rastin kur mbetet vetëm një njësi aktive ligjore.

Në fund është diskutuar se si mund të zgjerohet aplikacioni online për të trajtuar transaksionet e papërfunduara.

Sugjerimi është të ketë një dritare të veçantë, që liston transaksionet e papërfunduara. Kur selektohet transaksioni i papërfunduar, shfaqen njësitë relevante për zgjidhjen e rasteve (në rastin e diskutuar më lart, ndërmarrja dhe njësitë lokale). Kjo mund të bëhet duke përdorur format që tani më janë të vendosura.

Format për njësitë ligjore mund të zgjerohen me një buton veprimi, i cili, kur identifikon njësinë kryesore aktivizon procedurën që bën azhurnimin e nevojshëm në RSB. Kur zgjidhet, transaksioni i papërfunduar duhet të fshihet prej databazës.

Funksione të ngjajshme duhet të vendosen për lloje tjera të transaksioneve të papërfunduara.

Gjatë misionit të radhës do të bëhet rishikimi final i kësaj çështjeje. Qëllimi është të jemi në gjendjen, ku numri i transaksioneve të papërfunduara pas azhurnimit tremujor është më i vogël se 100 dhe koha për procesimin e tyre është 1 ose më së shumti 2 ditë pune.

#### **6. Misioni i radhës.**

Misioni i radhës, të udhëhiqet nga Søren Netterstrøm është caktuar të mbahet nga 22 Shkurt 2016. Do të jetë misioni i fundit mbi RSB në projektin e binjakëzimit.

Tema kryesore do të jetë rishikimi final i aplikacionit online dhe ndonjë çështje tjetër e pazgjidhurë.

## Aneksi 1. Termat e Referencës



**Projekti i Binjakëzimit i BE-së**  
**KS12 IB ST 01**  
**Përkrahje për Statistikat**

### Termet e Referencës:

#### **Komponenti 3: Statistikat e Biznesit**

**Aktiviteti 3.5.7: Përkrahja në përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve: Krijimi i procedurave për futjen e të dhënave dhe paraqitjes për përdoruesit**

#### **Orari:**

**TeR –data e përgatitjes:** 4 Janar 2016

**Fillimi / fundi i aktivitetit:** 19-22 Janar 2016

**Koha e raportimit:** 29 Janar 2016

#### **Rezultatet obligative të komponentit:**

| Rezultatet obligative | Intervenimi logjik | Standardet | Burimet e informacionit | Supozimet |
|-----------------------|--------------------|------------|-------------------------|-----------|
|-----------------------|--------------------|------------|-------------------------|-----------|

|                                       |   |  |   |   |
|---------------------------------------|---|--|---|---|
| <p><b>Rezultati obligativ 3.5</b></p> | <p><b>Përkrahje në përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB)</b></p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti i misionit, që paraqet fushat më të rëndësishme të veprimit, për përmirësimin e regjistrimit të bizneseve, i publikuar në ëbfaqen e projektit</li> <li>• Afati kohor dhe harta rrugore për përmirësim, të përcaktuara</li> <li>• Rekomandimet për procedurat e reja për të siguruar përditësimin e RSB-së nga burimet që janë në dispozicion</li> <li>• Drafti i tabelës korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2., i përditësuar</li> <li>• Tabela korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2, e finalizuar</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportet tremujore të Binjakëzimit</li> <li>• Raportet e Misionit</li> <li>• Harta rrugore</li> <li>• Afatet kohore</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapaciteti i mjaftueshëm i absorbimit</li> <li>• Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim</li> <li>• Stafit punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve</li> <li>• Termat e references, të përpiluara me kohe, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën</li> </ul> |
|---------------------------------------|---|--|---|---|

### **Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 3.5.7**

Ky mision është vazhdim i misionit të kaluar mbi RSB, në Dhjetor të vitit 2015. Misionet mbi RSB janë planifikuar të mbahen çdo dy muaj deri në fund të projektit.

Në misioni paraprak është trajtuar rishikimi i përgjithshëm i procesit të krijimit të njësive statistikore në RSB, një diskutim në lidhje me nevojën për Grupet e Ndërmarrjeve dhe si të trajtohen njësitë mbi llojin e aktivitetit.

Ky mision do të përfshijë punën në aplikacionin online dhe Njësitë Lokale. Më tej misioni do të diskutojë qëndrueshmërinë e projektit të RSB-së.

### **Rezultatet e pritura të aktivitetit 3.5.7:**

Raporti i misionit – përshkrimi i progresit, i realizuar gjatë misionit të fundit.

Vlerësimi i punës së kryer deri tani

Diskutimi për grupet e ndërmarrjeve

Rishikimi i afateve kohore

Sugjerimet për Termat e Referencës për aktivitetet e tjera mbi RSB.

### **Stafi i ASK-së:**

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, [muhamet.kastrati@rks-gov.net](mailto:muhamet.kastrati@rks-gov.net)

### **Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:**

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive

Kombetare, [Ilir.T.Berisha@rks-gov.net](mailto:Ilir.T.Berisha@rks-gov.net)

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, [teuta.zyberi@rks-gov.net](mailto:teuta.zyberi@rks-gov.net)

**Ekspertët e vendeve anëtare:**

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)

**Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:**

Z. Per Knudsen, RTA, [pkn@dst.dk](mailto:pkn@dst.dk)

Znj. Nora Zogaj, Asistente, [zogaj.nora@gmail.com](mailto:zogaj.nora@gmail.com)

**Përshkrimi i historikut për aktivitetin**

Ky mision është i bazuar mbi planin e përgatitur nga ekspertët e vendeve anëtare dhe eksperti i ASK-së gjatë misionit të fundit.

**Aktivitetet, që duhet të ndërmerren si përgatitje për misionin:**

- Të gjitha raportet e Komponentit 3 Statistikat e Biznesit mund t'i gjeni në [dst.dk/kosovo](http://dst.dk/kosovo)

**Aktivitet e pritura janë:**

- Përcjellja e aktiviteteve nga misioni i fundit
- Vlerësimi i punës së kryer deri tani
- Diskutimi për grupet e ndërmarrjeve
- Zhvillimi i mëtejshëm i databazës

**Rezultatet e pritura:**

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Rekomandimet për grupet e ndërmarrjeve
- Plani i detajuar për aktivitetet tjera të kompletohet, sa i përket RSB-së në Kosovë nga ana e programit të binjakëzimit

**Aneksi 1. Programi, - Janar 2016**

| Dita     | Vendi | Koha        | Ngjarja  |
|----------|-------|-------------|--|
|          |       |             |  |
| <b>1</b> | ASK   | 09.00       | ASK: Gjendja aktuale e RSB   |
|          |       | 10:30       | Pushim për kafe  |
|          |       | 11:00       | Planifikimi javor. Vlerësimi i RSB dhe punës së kryer. Diskutimi për grupet e ndërmarrjeve |
|          |       | 12:00       | Dreka  |
|          |       | 13:30-15:30 | Vlerësimi i RSB dhe punës së kryer<br>Diskutimi për grupet e ndërmarrjeve                  |
|          |       |             |  |
| <b>2</b> | ASK   | 09:00-16:00 | Vlerësimi i RSB dhe punës së kryer<br>Diskutimi për grupet e ndërmarrjeve                  |
|          |       |             |  |
| <b>3</b> | ASK   | 09:00-16:00 | Puna rreth RSB   |



|          |     |             |  |
|----------|-----|-------------|--|
|          |     |             |  |
| <b>4</b> | ASK | 09:00-16:00 | Puna rreth RSB   |
| <b>5</b> | ASK | 09:00       | Shkrimi i raportit                                       |
|          |     | 10:00       | Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA |
|          |     | 10:30       | Pushim për kafe  |
|          |     | 10:00       | Shkrimi i raportit                                       |
|          |     | 12:00       | Dreka  |
|          |     | 13:00       | Shkrimi i raportit                                       |

## Aneksi 2. Personat e takuar

**Stafi i ASK-së:**

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, [muhamet.kastrati@rks-gov.net](mailto:muhamet.kastrati@rks-gov.net)

**Ekipi i Binjakëzimit i ASK-së:**

Udhëheqës i Projektit Mr. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare, [Ilir.T.Berisha@rks-gov.net](mailto:Ilir.T.Berisha@rks-gov.net)

**Ekspertët e vendeve anëtare:**

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)

**Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:**

Z. Per Knudsen, RTA, [pkn@dst.dk](mailto:pkn@dst.dk)

Znj. Nora Zogaj, Asistente, [zogaj.nora@gmail.com](mailto:zogaj.nora@gmail.com)